



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 515/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Goran Lazic nga subjekti politik SLS, për shkak të kërcënimit gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

REUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije.

## A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik Srpska Demokratska Stranka Kosova i Meohije, me te cilën pretendohet se në Vendvotim nr.3405e/01R dhe nr.3405e/02R, në fshatin Gushterica e Poshtme ka ardhur deri tek prishja e qetësisë publike nga kërcënimet dhe fryrjet që i ka bërë Goran Lazic nga subjekti politik SLS , në drejtim të nën kryetarit të Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije, Nedeljko Aleksandër, gjë që është në kundërshtim me udhëzimin për këshillat e vendvotimeve të dhëna nga Zyrtari Ekzekutiv i KQZ-së.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 515/2010 më datën 16.12.2010.

